

Sadete PLLANA

Gani PLLANA

VËSHTRIM I ZHVILLIMIT TË FUSHAVE TË DIJES DHE I TERMINOLOGJISË TEKNIKE SHQIPE

UDC 811.18'373.46

Abstrakti: Shfaqja dhe zhvillimi i fushave të dijes kushtëzohen në radhë të parë nga nevoja që ndjen shoqëria për to dhe si të tilla janë në varësi të kushteve historiko-shoqërore, ekonomiko-sociale, kulturore e zhvillimi të shoqërisë. Kështu, p.sh., përsa i përket Shqipërisë vetëm në fund të shek. 19-të ishin pjekur kushtet historiko-shoqërore, ekonomiko-sociale e kulturore për shfaqjen dhe zhvillimin e një rrethi, ndoshta të ngushtë, fushash dije, të cilat u zgjeruan ose, më së shumti, u diferencuan më vonë duke dhënë një varg fushash të tjera. Në Kosovë, kushtet historiko-shoqërore ndikuan që të kemi një vonesë në zhvillimin e terminologjisë teknike shqipe pas viti 1970 (me hapjen e Universitetit të Prishtinës). Historia e lindjes dhe e zhvillimit të sistemeve konceptore të fushave të ndryshme të dijes në format empirike në fillimet e tyre dhe, më vonë, shkencore të mirëfillta, tregon se secili sistem konceptor ose, më saktë, një pjesë ose baza e tij është ndërtuar mbi një ose disa baza ose në kombinim me njëra tjetrën, të pranishme edhe sot në masa të caktuara në çdo sistem konceptor dhe që pasqyrohen si të tilla në sistemin përkatës terminologjik si leksik special, çka vihet re në mënyrë të theksuar në terminologjitë teknike të shqipes. Kjo do të thotë se një fushë dije, e ngritur mbi një fushë të caktuar, shërben vetë si bazë për një fushë tjetër.

Fjalët kyçe: fushat e dijes, terminologjia, sistemi konceptor, terminologjitë teknike

SURVEY OF THE DEVELOPMENT OF KNOWLEDGE FIELDS, AND OF THE ALBANIAN TECHNICAL TERMINOLOGY

Abstract: The emergence and development of these fields are conditioned, first of all, by the need that society feels for them and as such they are dependent on socio-historical, socio-economical, cultural and social development conditions. Thus, for example, as far as Albania is concerned, only by the end of the 19th century socio-historic, socio-economic and cultural conditions had ripened for the emergence and development of a circle, perhaps a narrow one at first, of knowledge fields which expanded, or mostly differentiated later by producing a range of other fields. In Kosova, the socio-economic conditions contributed to the delay in the development of the Albanian Technical terminology after 1970 (with the opening of the University of Prishtina). The history of origination and development of conceptual systems of various fields of knowledge, in empirical forms at their conception, and later, scientific, shows that each conceptual system or more precisely, one part or its base is built upon one or several bases or in combination with each other. These being present even today in certain measures in every conceptual system and which are reflected as such in the relevant terminology system as a special vocabulary, which is quite noticeable in the technical terminology of the Albanian language. This means that a field of knowledge, set up on a certain field, serves as a basis for another field.

Keywords: areas/fields of knowledge, terminology, conceptual system, technical terminology

Zhvillimi i fushave të dijes dhe i terminologjisë teknike

Historia e shfaqjes dhe e zhvillimit të këtyre fushave të dijes në Shqipëri hedh dritë mbi marrëdhëniet në të cilat ato kanë hyrë me faktorët shoqërorë si edhe tregon se cilat lloje faktorësh kanë qenë mbizotërues në shfaqjen e zhvillimit të tyre. Kështu, p.sh., në fund të shekullit të 19-të shfaqjen e një varg fushash dije e kushtëzuan faktorët politikë, kulturorë e gjuhësorë, të cilat lidheshin pazgjidhshmërisht me përpjekjet e popullit tonë për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare përmes ngritjes së nivelit kulturor e arsimor të popullit. Disa shkenca, nëpërmjet fushave speciale bazë të saj, do të ishte një nga ata faktorë që do ta realizonte këtë qëllim. Faktorë të tjerë ishin dhe ngritja e shkollave dhe përgatitja e teksteve mësimore përkatëse, në të cilat gjuha e shkruar ishte forma e realizimit të tyre. Në to gjetën mishërimin e tyre fushat e para bazë të dijes si *matematika, gjuhësia, gjeografia, astronomia*, të cilat çuan në krijimin e terminologjive përkatëse nga rilindësit tanë të mëdhenj si: S. Frashëri¹, N. Frashëri, K. Kristoforidhi, e më vonë të ndjekur nga A. Xhuvani², E. Çabej etj. Pra, sistemet konceptore të fushave të dijes në fillesat e tyre u ngritën mbi bazën e koncepteve, të krijuara drejtpërdrejt posaçërisht për këto fusha. Në fushat e mëtejshme shfaqen e zhvillohen fusha të tjera, një pjesë mbi bazën e fushave ekzistuese nga diferencimi i tyre si nga matematika: *algjebra-gjeometria-stereometria*, nga fizika: *mekanika-elektriciteti-optika*, një pjesë tjetër mbi bazën e fushave të veprimitarise praktike njerëzore si: *agronomia, veterinaria, pylltaria* etj.

Fushave bazë të dijes me sistemet konceptore të tyre u përgjigjeshin terminologjitë përkatëse në formën e sistemeve të thjeshta, por me aftësi potenciale për t'u zhvilluar më tej nën ndikim e gjithë faktorëve jashtëgjuhësorë e brendagjuhësorë, çka çoi në zgjerimin e bazave të këtyre fushave dhe të terminologjive përkatëse, si edhe në shfaqjen e zhvillimit të fushave dhe të terminologjive të tyre.

Fazat në të cilat kanë kaluar faktorët e ndryshëm jashtëgjuhësorë e brendagjuhësorë kanë ravijëzuar edhe fazat nëpër të cilat do të kalonte zhvillimi i këtyre fushave dhe i terminologjive përkatëse. Përsa u përket faktorëve kulturorë, ata u mishëruan në tre fazat themelore të zhvillimit të sistemit arsimor në vendin tonë, në fazën e ulët, në fazën e mesme dhe në fazën e lartë. Këta faktorë kushtëzuan fazat dhe nivelin e arritur në këto faza të formimit të fushave të dijes dhe terminologjive përkatëse të tyre. Kështu, këto fusha dhe terminologjitë përkatëse të tyre kaluan nëpër këto faza kryesore deri sa arritën në gjendjen e nivelin e sotëm të zhvillimit më të lartë.

Faza e nivelit të ulët, që përfshinte pak a shumë fundin e shek. XVIII deri në shpalljen e pavarësisë së vendit (viti 1912), lidhet me shfaqjen dhe zhvillimin e fushave bazë të dijes me terminologjitë përkatëse, gjë që u kushtëzua nga përhapja në pjesën më të madhe në vendin tonë të shkollave shqipe të ciklit të ulët e më vonë deri në atë shtatëvjeçar. Në to u futën lëndët mësimore që lidheshin me fushat bazë të dijes si: *aritmetika*³, *gjeometria, gjuha, algjebra, fizika*. Për këto lëndë sigurisht ishin përgatitur edhe tekstet mësimore⁴ përkatëse, në të cilët për herë të parë krahas leksikut të zakonshëm, takoheshin edhe fjalët e para speciale, termat, të cilët përbënin bazën e informacionit shkencor të fushave përkatëse të dijes. Merita e atyre që i krijuan këto fjalë speciale (termat) që shumë e madhe, sepse, në radhë të parë, ata i krijuan pa pasur një bazë trashëgimore nga e kaluara. Megjithatë krijuesit e tyre u mbështetën në bagazhin diyor të tyre, mbi sistemet konceptore të përvetësuara në

¹Sh. Demiraj, "Ndihmesa e Sami Frashërit në lëvizimin e gjuhëshqipe" në "GJUHA SHQIPE Problemedhedisafiguratëshquaratësaj", Tiranë, 2003, f. 215-229.

²A. Xhuvani-E. Çabej, "Prapashtesat e gjuhëshqipe", VEPRA I, Tiranë, 1980, f. 418-581.

³H. Pasho, "Leksikuterminologjiknëveprënëmësimore-didaktiketëNaimFrashërit" në "STUDIME FILOLOGJIKE", nr.2., Tiranë, 1991.

⁴H. Myzyri, "Shkollat e para kombëtare shqipe", Tiranë, 1973.

shkollat kryesore jashtë vendit përmes gjuhëve të huaja që zotëronin, duke shfrytëzuar të gjitha aftësitë potenciale të shqipes për të krijuar njësitë përkatëse leksikore që u përgjigjeshin koncepteve përkatëse si edhe duke shfrytëzuar edhe brumin përkatës të shqipes për t'i ngritur fjalët e zakonshme të saj në nivelin e fjalëve speciale, të termave. Një pjesë e këtij leksiku special, të ndërtuar mbi këto dy baza, me krijime të reja dhe mbi brumin ekzistues të gjuhës, qëndron në themelet e terminologjive të fushave kryesore të dijes dhe të terminologjive teknike edhe sot si: *numër, mbledhje, pjesëtim* (arit.), *kënd, trekëndësh, brinjë, rreth, rreze* (gjeom.), *emër, mbiemër, folje* (gjuh.), *shkronjë, rrënjë, fuqi* (algj.), *forcë, madhësi* (fiz.) etj.

Faza e nivelit të mesëm përfshin kryesisht fushat e dijes me terminologjitë përkatëse, të cilat u zhvilluan në suazën e krijimit të arsimit të mesëm. Kjo fazë shënon dy dukuri kryesore: së pari, zgjerimin e njësive përbërëse konceptore të fushave bazë, çka çoi në zgjerimin në sasi e cilësi të njësive leksikore (të termave) dhe së dyti krijimin e një varg fushash të reja dije mbi baza të ndryshme. Kështu, u zgjerua dhe u pasurua me njësi të reja fondi leksikor special i fushave bazë si *aritmetikë; gjeometri; gjuhësi*; kurse nga ana tjetër u krijuan një varg fushash të tjera bazë si *kimia, psikologjia, pedagogjia, ekonomia, tregtia, e drejta, anatomia, fiziologjia*. Krijimi i këtyre fushave u kushtëzua nga kushtet e reja politike, ekonomike, kulturore në vend si edhe nga nevoja e futjes së tyre në shkollë si disiplina të veçanta mësimore për përgatitjen e specialistëve të nivelit të ulët e të mesëm në degët e arsimit, ekonomisë, mjekësisë, bujqësisë (si mësues, ekonomistë, ndihmës mjekë, agronomë të mesëm, veterinerë, mekanikë, ndërtues, elektroteknikë etj.) Që në këtë fazë mund të veçohen dy grupe të mëdha fushash të dijes që lidhen me fushat e dijes: fushat që i përkasin teorisë dhe fushat që kanë të bëjnë me veprimtarinë praktike (teknikën, teknologjinë). Si njëra, ashtu edhe tjetra fushë filluan të diferencohen më vonë në fusha të tjera, në të cilat si ana teorike (teoria), ashtu edhe ana praktike pleksen me njëra tjetrën, siç është p.sh. shkenca dhe teknika (teknologjia) në fushat e *kimisë, bujqësisë me fushat e agronomisë, veterinarisë* etj.

Faza e nivelit të lartë, në rrafshin e shkencës dhe të teknikës (teknologjisë) i përket periudhës pas viteve '50-të të shekullit të kaluar. Ajo kushtëzohet nga nivelet e zhvillimit modern të shoqërisë. Një ndikim të madh ushtrojnë në mënyrë të veçantë faktorët ekonomikë (futja e teknologjive të reja), kulturorë (arsimi i lartë, kontaktet me botën përmes literaturë së huaj), kurse sot, hapja me botën, ekonomia e tregut të lirë etj.

Bazat konceptore të fushave teknike të dijes si sisteme

Historia e zhvillimit të terminologjisë si leksik tërësor në çdo gjuhë, të hershme a të mëvonshme, në nivelin e gjuhës së shkruar tregon se gjendja e arrirë e saj, në një prerje të caktuar kohore është kushtëzuar nga zhvillimi i sistemeve konceptore të fushave përkatëse të dijes, të cilat përbëjnë edhe parakushtin më qenësor të çdo terminologjie si leksik special në krahasim me leksikun e përgjithshëm. Ky konceptim zbulon edhe bazën reale të çdo terminologjie në rrafshin e përmbajtjes, çka bën të mundshme të hidhet dritë mbi rrugën e lindjes, të zhvillimit dhe të formësimit të saj në çdo gjuhë. Kjo shpjegon edhe bashkëlidhjen e brendshme dhe marrëdhëniet e ngushta të sistemeve konceptore të fushave përkatëse të dijes me sistemet e njësive gjuhësore (të termave) të këtij leksiku special, të cilat shërbejnë për ruajtjen, tejçimin e informacionit jashtëgjuhësor në procesin e komunikimit ndërmjet njerëzve sidomos në gjuhën e specializuar.

Historia e lindjes dhe e zhvillimit të sistemeve konceptore të fushave të ndryshme të dijes në format empirike në fillesat e tyre dhe, më vonë, shkencore të mirëfillta, tregon se secili sistem konceptor ose, më saktë, një pjesë ose baza e tij është ndërtuar mbi një ose disa baza ose në kombinim me njëra

tjetrën, të pranishme edhe sot në masa të caktuara në çdo sistem konceptor dhe që pasqyrohen si të tilla në sistemin përkatës terminologjik si leksik special, çka vihet re në mënyrë të theksuar në terminologjitë teknike të shqipes.

1. Sistem konceptor (mikrosistem konceptor) i ndërtuar mbi bazën e një sistemi (*mikrosistemi*) *empirik të një fushe të veprimtarisë* praktike njerëzore.
2. Sistem konceptor (mikrosistem konceptor) i ndërtuar mbi bazën e *zhvillimit në vetvete* të vetë sistemit të fushës përkatëse.
3. Sistem (mikrosistem) i ndërtuar *mbi bazën e mikrosistemeve të fushave themelore*.
4. Sistem konceptor (mikrosistem konceptor) i formuar nga *diferencimi i fushave* të dijes, si një nga degët e këtij diferencimi.
5. Sistem konceptor (mikrosistem konceptor) i krijuar mbi bazën e *kryqëzimit* të sistemeve konceptore të fushave të dijes.
6. Sistem konceptor (mikrosistem konceptor) i krijuar brenda fushës si *zgjerim i një koncepti* (objekti) brenda sistemit.

1. *Sistemi konceptor (mikrosistemi konceptor)* i një fushe të dijes, i ndërtuar mbi bazën e një *sistemi (mikrosistemi) konceptor empirik të një fushe të veprimtarisë praktike njerëzore* ka të bëjë kryesisht me një fushë të zbatuar të dijes, ku *teoria dhe praktika (shkenca dhe teknika)* kombinohen njëra me tjetrën, por gjithsesi si bazë shërben praktika (teknika). Këtu mund të përmendim si fusha më të spikatura të dijes në rrafshin më të gjerë si disa fusha të *bujqësisë*, si: *agronominë, veterinarinë, pylltarinë; ndërtimin* me koncepte të ndryshme që lidhen me vetë ndërtimin, të shprehur nga një sistem termash përkatës: *gur, tjegull, llaç, gëlqere; prag, tavan, dysheme, çati, hidraulikën, hidroteknikën*. Po këtu mund të futen fusha të ndryshme që lidhen me *mekanikën*: (teknikën si veprimtari të thjeshtë dije me fushën e zanateve) të shënuar nga termat: *rrotë, shtrat, bosht; gjuetinë (hark, shigjetë, kordhë)* etj.

Ngritja e një sistemi konceptor (shkencor) mbi sistemin konceptor empirik është kushtëzuar kryesisht me kalimin e objekteve (koncepteve) nga njëri sistem tek tjetri, si p.sh. në fushën e agronomisë konceptet “bimë”, me pjesët e tyre, veprimet me to, gjithë konceptet që lidhen me konceptin “tokë”, të cilat integrohen në fushat teknike, lidhur me veprimet e veglave, me proceset si: *lërim, mbjellje, korrije, shirje* etj.

Po kështu në veterinari konceptet e lidhura me konceptin “*kafshë*”, në ndërtim konceptet e lidhura me konceptin “*ndërtim*” etj. Një pjesë konceptesh kanë kaluar nga njëri sistem tek tjetri pa ndryshim të bazës konceptore, si p.sh. lloje bimësh si “*grurë*”, “*misër*”, “*bimë*”, “*tokë*”, “*kore*” etj. Disa të tjera kanë ndryshuar bazën konceptore dhe ndryshuar formën e shprehjes, kurse të tjera kanë ndryshuar bazën konceptore dhe emërtimin si në shqip: *parmendë* → *plug*, *lërim* → *plugim*, (*lëroj-plugoj*), *mokërr* → *gur mulliri* → *fabrikë bloje*, “*gur mulliri*” → “*cilindër bloje*”, “*mulli*” → “*fabrikë bloje*” (mek.) etj.

2. Sistemi konceptor i krijuar mbi bazën e *zhvillimit në vetvete* të tij i përket kryesisht një fushe dije, e që formohet *si e re, me sistemin konceptor të vet*. Megjithatë ky sistem *mbështetet mbi njohjen empirike* të realitetit dhe mbi përvojën e veprimtarisë praktike, por duke krijuar *koncepte të reja abstrakte mbi bazën e induksioneve dhe deduksioneve logjike*, fillimisht në formën e mikrosistemeve të veçanta, siç janë konceptet për numrat, veprimet me to, dukuri të vërejtura brenda tyre, për figurat gjeometrike, për zëvendësimet e numrave me shkronjat, për elementet përbërëse të gjuhës, për proceset e të menduarit, për dukuritë e natyrës etj., të cilat kanë shërbyer si bazë teknike-shkencore për fushat teknike. Kështu lindën sistemet konceptore, të cilat si bashkësi më vete krijuan fusha të tilla (degë të shkencës) si filozofia, matematika, gjeometria, fizika, gjuhësia etj. Si veçori e sistemeve konceptore të këtyre fushave është se ato u bartën nëpërmjet terminologjive përkatëse nga njëri areal gjuhësor në

tjetrin, duke u plotësuar dhe u pasuruar më tej. Në gjuhën shqipe ato i përkasin shek. 18-19-të, që fillojnë me periudhën e Rilindje Kombëtare. Përveç kësaj, në fazat më të larta të zhvillimit të tyre, si koncepte kryesisht abstrakte, u huazuan fusha të tjera, duke u vënë një pjesë e koncepteve të tyre, në themel të këtyre fushave, duke shërbyer si bazë teorike edhe për fushat e zbatuara, si p.sh. matematika, gjeometria, fizika për fushat e zbatuara (mekanikë, ndërtim, elektricitet). Nga ana tjetër, nga diferencimi i tyre i mëtejshëm lindën një varg nënfushash, duke krijuar fusha të reja si *stereometria*, *trigonometria*(nga *gjeometria*), ku bazën e tyre e përbënin konceptet bazë të shprehura nga termat *numër, kënd, rreth, vijë, pikë* etj.

3. Sistemi konceptor që ka bazën e vet, por *huazon* edhe një varg konceptesh nga fusha të tjera të dijes, kryesisht nga fusha të reja të dijes, si, p.sh., *informatikës*, që merr terma nga matematika, logjika, elektriciteti, gjuhësia etj.

4. Sistemi konceptor, që formohet nga *diferencimi i një fushe* të caktuar, e cila me zhvillimin e mëtejshëm të saj, i zgjeron së tepërmi kufijtë e saj. Kjo fushë dije, e cila rezulton nga zhvillimi në gjerësi dhe në thellësi i një fushe të gjërë, mëvetësohet si entitet, por që ka lidhje me fushën e gjerë, nga e cila vjen si edhe me secilën fushë të veçantë. Në fillim të krijimit të vet ajo nuk është plotësisht e diferencuar në pjesë të veçanta, por më vonë, me zhvillimin e mëtejshëm, duke u plotësuar e pasuruar me koncepte të reja, ngrihet në nivelin e një fushe. Kështu, p.sh. nga *fizika* kanë dalë e janë zhvilluar si fusha më vete *mekanika, elektriciteti, optika*, kurse, më vonë, secila prej tyre ka evoluar në fusha të tjera me sistemet e veta konceptore si nga *elektriciteti* janë formuar: *elektromagnetizmi, elektroteknika, elektronika* etj.

5. Sistemi konceptor, i ndërtuar mbi bazën e *kryqëzimit të fushave të dijes*, në të cilën përmbahen pjesë nga sisteme të tjera konceptore. Nga kombinimi i elementëve përbërës të tyre krijohen koncepte të reja, një pjesë që huazohen nga fushat e tjera. Këtu mund të sjellim si shembull një varg fushash si: *biokimia, biofizika, kimia fizike, bioteknologjia, mekatronika, gjuhësia kompjuterike, radio-komunikimi* etj.

6. Brenda një sistemi konceptor të një fushe dije një koncept që përfaqëson një objekt kompleks të fushës në fjalë mund të *zgjerohet e pasurohet në elementet* përbërës të tij dhe në marrëdhëniet ndërmjet tyre në masë të tillë, sa që mund të përfaqësojë një fushë më vete. Kështu, p.sh., nga fusha e *mekanikës së zbatuar* veçohen një varg sistemesh konceptore, secili nga të cilat lidhet përkatësisht me objekte të tilla si *automobili, makina metalprerëse, makina hidraulike, makina ndërtimi, makina tekstile*. Secili nga këto objekte përfaqësohet nga një shumësi konceptesh që në tërësinë e tyre përbëjnë një fushë si entitet në vetvete.

Bibliografia

Berani, Sh: “Gjendja e terminologjië shqipe në Jugosllavi” në “GJENDJA E TERMINOLOGJISË SHQIPE NË JUGOSLLAVI”- Punim nga Sesioni shkencor i mbajtur në Prishtinë më 28 dhe 29 janar 1988, Prishtinë, 1988.

Demiraj, Sh.: “Ndihmesa e Sami Frashërit në lëvrimin e gjuhës shqipe” në GJUHA SHQIPE Probleme dhe disa figura të shquara të saj, Tiranë, 2003.

Dervishi, V.: “Termet e mekanikës në gjuhën shqipe dhe burimi i tyre konceptor” në “Sf”, nr.1, Tiranë, 1991.

Duro, A.: “Fjala shqipe në terminologjinë e mekanikës”, në “STUDIME FILOLOGJIKE”, nr.4, Tiranë, 1984.

Duro, A.: “Terminologjia si sistem”, “Panteon”, Tiranë 2001.

- Duro, A.: *"Studime gjuhësore (terminologji, gjuhësi kompjuterike, kritikë-bibliografi)"*, QSA IGJL, Tiranë, 2012.
- Duro, A; Pllana, G.: *"Marrëdhëniet logjike ndërmjet shenjave njëfjalëshe e togfjalëshe në terminologji"* në KONFERENCA SHKENCORE JAVA E ALBANOLOGJISË IAP 6/2015, 15-19 qershor 2015, Prishtinë, 2015.
- Felber, H.: *"Terminology manual"*, UNESCO and Infoterm, Paris, 1984.
- Kostallari, A.: *"Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë"*, në "Sf", nr.4, Tiranë, 1984.
- Lafe, E.: *"Leksiku terminologjik si problem gjuhësor dhe kombëtar"* në "GJENDJA DHE ZHVILLIMI I TERMINOLOGJISË SHQIPE PROBLEME DHE DETYRA" KONFERENCËSHKENCORE, ASHSH dhe ASHAK, Tiranë, 2009.
- Leka, F.: *"Terminologjia tekniko-shkencore dhe gjuha e sotme letrare shqipe"* në STUDIME MBI LEKSIKUN DHE MBI FORMIMIN E FJALËVE NË GJUHËN SHQIPE III, ASHSH, Tiranë, 1989.
- Memisha, V.: *"Fjalor i termave themelorë të mekanikës"* në "GJUHA JONË" nr.3-4, Tiranë, 2002.
- Murati, Q.: *"Për një terminologji më të saktë e më shkencore të gjuhës sonë"* në "GJENDJA E TERMINOLOGJISË SHQIPE NË JUGOSLLAVI"- Punim nga Sesioni shkencor i mbajtur në Prishtinë më 28 dhe 29 janar 1988, Prishtinë, 1988.
- Myzyri, H.: *"Shkollat e para kombëtare shqipe"*, Tiranë, 1973.
- Pasho, H.: *"Leksiku terminologjik në veprën mësimore-didaktike të Naim Frashërit"* në "Sf", nr.2., Tiranë, 1991.
- Pllana, G.: *"Standardizimi i terminologjisë së inxhinierisë mekanike në gjuhën shqipe nevojë e kohës"*, në ALBANOLOGJIA International Journal of Albanology, Vol.1, No:1-2/2014, UDK:81, USHT Tetovë, 2014.
- Pllana, G.: *"The study of mechanics terminology in Albanian language (In comprehensive terminology and in a special subfield)"* në SLATE 2015 The Asian Conference on Second Language Acquisition and Teacher Education August 2-4, 2015, Hiroshima, 2015.
- Pllana, G.: *"PROCESE TË TERMINOLOGJIZIMIT NË GJUHË"*, Konferencë shkencore ndërkombëtare QSA, 11 korrik 2015, Tiranë, 2015.
- Pllana, G.: *"The study of mechanics terminology in Albanian language (On the level of general terminology and a comprehensive special subfield)"*, SLATE 2015 Proceedings The Asian Conference on Second Language Acquisition and Teacher Education, August 2-4, 2015, Hiroshima, Japoni.
- Pllana, G.; Pllana, S.: *"Gjendja dhe probleme të zhvillimit të terminologjisë së mekanikës teorike"* në Seminar i VI- të i Albanologjisë, 20-23 shtator 2012, Tetovë-Shkup 2012.
- Pllana, S.: *"Terminologjia bazë e mekanikës në gjuhët shqipe dhe angleze"*, QSA IGJL, Tiranë, 2014.
- Proko-Jazexhiu, Vilma: *"Probleme të motivimit në terminologjinë e agronomisë"* në "GJUHA SHQIPE" nr.1, Tiranë, 2006.
- Proko-Jazexhiu, Vilma: *"Leksiku terminologjik i agronomisë në gjuhën shqipe"*, QSA IGJL, Tiranë, 2012.
- Shehu, H.: *"Rreth fjalëve angleze ose me prejardhje nga anglishtja në gjuhën e sotme shqipe"* në "SEMINARI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE", Prishtinë, 2001.
- Shumeli, A.: *"Formimi dhe funksionimi i terminologjisë së agromekanikës në shqipe në përqasje me anglishten"*, disertacion, QSA Tiranë, 2013.
- Thomai, J.: *"Ligjërata pasuniversitare (leksikologji, semantikë, leksikografi)"*, UNIVERSITETI "FAN S.NOLI", Korçë, 2015.
- Xhuvani, A.: *"Vepra I"*, Tiranë, 1991.
- Xhuvani, A; Çabej, E.: *"Prapashtesat e gjuhës shqipe"*, VEPRA I, Tiranë, 1980.